

LIGJ (projekt, dt_5 Nëntor 2010)

Nr_____, date_____

PËR INSPEKTIMIN NE REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Ne mbështetje te neneve 78 dhe 83, pika 1 te Kushtetutës, me propozim te Këshillit te Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKE SE SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I

DISPOZITA TE PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Ky ligj përcakton parimet e përgjithshme te inspektimit dhe organizimit te trupave inspektuese, statusin e inspektoreve, organizimin, funksionimin dhe funksionet e Inspektoratit Qendror, si dhe rregullat e procedimit administrativ te inspektimit.

Neni 2

Fusha e veprimit

1. Ky ligj është i zbatueshëm për funksionet e inspektimit ne juridiksionin e institucioneve qendrore dhe njësive te qeverisjes vendore, përveç:
 - a. inspektimit te brendshëm me karakter administrativ ne sektorin publik;
 - b. auditimit te brendshëm ne sektorin publik dhe inspektimit financiar publik;
 - c. kontrollit tatimor dhe atij doganor;
 - d. inspektimit te autoritetit përgjegjëse për mbikëqyrjen e zbatimit te legjislacionit për parandalimin e pastrimit te parave dhe financimin e terrorizmit.

2. Dispozitat e këtij ligji janë të zbatueshme për atë që nuk parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji i posaçëm që rregullon një funksion të caktuar inspektimi dhe plotësohen me dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurave Administrative

Neni 3

Përkufizime

1. Në kuptimin e këtij ligji

- a. **“kërkesat ligjore”** janë kërkesat e përcaktuara nga një ligj, akt nënligjor apo një leje, licence apo autorizim të dhënë në bazë dhe në zbatim të ligjit dhe që janë të detyrueshme për të respektuar gjatë ushtrimit të një veprimtarie të natyrës tregtare, ekonomike apo profesionale.
- b. **“subjekti i inspektimit”** është çdo person fizik apo juridik që ka, sipas ligjit, detyrimin të respektojë një kërkesë ligjore.
- c. **“inspektim”** është çdo formë kontrolli që trupa kompetente kryen për verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore nga subjekti i inspektimit.
- d. **“inspektim rastësor”** është ajo formë inspektimi në të cilin subjekti i inspektimit është i përcaktueshëm në bazë të marrëdhënies me një ngjarje të përcaktuar, si p.sh: kalimi në një periudhë të përcaktuar në një rrugë publike ku ushtrohet inspektimi, apo ushtrimi i veprimtarisë në një zonë gjeografike apo një treg të caktuar.
- e. **“inspektimi në vend”** është inspektimi që kryhet në vendin apo vendet e ushtrimit të veprimtarisë së subjektit të inspektimit;
- f. **“ministri përgjegjës”** është ministri që mbulon fushën shtetërore të veprimtarisë, sipas përcaktimit të legjislacionit në fuqi për një funksion të caktuar inspektimi.
- g. **“ministrja përgjegjëse”** është ministrja që mbulon fushën e veprimtarisë, sipas përcaktimit të legjislacionit, në fuqi për një funksion të caktuar inspektimi;
- h. **“institucion qendror”** është Këshilli i Ministrave, çdo ministri dhe çdo institucion publik në varësi të tyre.

KREU II

QELMI DHE PARIMET E INSPEKTIMIT

Neni 4

Qëllimi i Inspektimit

1. Inspektimi ka për qëllim mbrojtjen e interesit publik dhe interesave të ligjshme të personave fizike dhe juridike.
2. Qëllimi i veprimtarisë së inspektimit arrihet nëpërmjet:
 - a. përcaktimit të gjendjes së respektimit të kërkesave ligjore nga subjekti i inspektimit;
 - b. këshillimit të subjektit të inspektuar për zbatimin sa më korrekt të kërkesave ligjore;
 - c. urdhërimit të korigjimit të shkeljeve të konstatuara të kërkesave ligjore dhe eliminimit të pasojave që rrjedhin prej tyre;
 - d. dhënies së dënimeve dhe marrjes së masave të tjera parashikuara nga ky ligj apo legjislativi i posaçëm.

Neni 5

Parimi i Pavarësisë të inspektimit

1. Inspektori brenda kompetencave të dhëna nga ligji apo akti nënligjor, është plotësisht i pavarur në kryerjen e procedimit të inspektimit dhe marrjen e vendimeve për një rast konkret.

Neni 6

Parimi i proporcionalitetit në veprimtarinë e inspektimit

1. Në kryerjen e inspektimit, inspektori duhet të kryejë veprimet e inspektimit në mënyrë të tillë që të ndërhyjë në veprimtarinë e subjektit të inspektuar vetëm për atë që është e nevojshme për kryerjen e një inspektimi efektiv.
2. Në përcaktimin e tipit të dënimeve apo masave që duhen marrë, inspektori, në përputhje me rëndësinë e shkeljeve të konstatuara apo pasojave të tyre, vendos atë masë që arrin qëllimin e inspektimit dhe që është në të njëjtën kohë cenon me pak subjektin e inspektimit dhe
3. Në përcaktimin e një afati, për korigjimit të shkeljeve të konstatuara dhe eliminimit të pasojave të tyre, nga subjekti i inspektimit, inspektori merr në konsideratë rëndësinë e

shkeljes, pasojat e saj dhe rrethanat qe përcaktojnë kohën e nevojshme për kryerjen e veprimeve për këtë qëllim, me përpjekjet maksimale nga ana e subjektit të inspektimit.

Neni 7

Parimi i prezumimit të pafajësisë dhe barra e provës

Veprimtaria e subjektit të inspektuar prezumohet në përputhje me kërkesat ligjore deri sa vërtetohet e kundërta. Subjekti i inspektuar nuk është i detyruar të provojë se veprimtaria e tij është në përputhje me kërkesat ligjore.

Neni 8

Parimi i inspektimit të programuar

Një subjekt mund të inspektohet vetëm në zbatim të programit të inspektimit, të hartuar në baze të vlerësimit të riskut dhe të miratuar. Përgjatimisht, një subjekt, mund të inspektohet jashtë programit në rastet e parashikuara shprehimisht nga ligji.

Neni 9

Parimi i dispozitës me të favorshme ligjore

1. Në rastin kur dispozita ligjore në baze të cilave vepron inspektimi nuk janë të qarta apo bien në kundërshtim me njëra tjetrën, inspektori vepron në mënyrën që cenon më pak subjektin e inspektimit.
2. Në rastet kur subjekti i inspektimit ka vepruar në përputhje me një kërkesë ligjore që bie në kundërshtim me një kërkesë tjetër ligjore, veprimi i tij nuk do të konsiderohet si në shkelje të ligjit.

Neni 10

Parimi i këshillimit dhe informimit

1. Inspektori siguron këshillimin e subjekteve të interesuara për parandalimin dhe shmangien e shkeljes të kërkesave ligjore, në mënyrë të thjeshtë, kuptueshme dhe pa pagesë,

2. Inspektori, gjithashtu, informon subjektin e inspektuar mbi te drejtat dhe detyrimet e tij ne procedimin administrativ te inspektimit dhe me pasojat ligjore te veprimeve apo mosveprimeve gjate këtij procedimi.

Neni 11

Parimi i informimit publik

1. Inspektori informon publikun mbi konstatimet dhe masat e marra gjate procedimit administrativ te inspektimit, nëse kjo është e nevojshme për mbrojtjen e te drejtave dhe interesave te personave fizike e juridike.
2. Informimi sipas parimit te përcaktuar ne piken 1 behet ne baze dhe brenda kufijve te përcaktuara nga kryeinspektori përkatës ne përputhje me legjislacionin ne fuqi për mbrojtjen dhe e te dhënave personale dhe atyre qe lidhen me veprimtarinë tregtare apo profesionale te subjektit te inspektimit apo personave te tjerë.

KREU III

ORGANIZMI DHE FUNKSIONIMI I INSPEKTORATEVE DHE INSPEKTORATI QENDROR

Seksioni 1

Organizimi dhe funksionimi i inspektorateve shtetërore

Neni 12

Inspektoratet shtetërore

1. Funksionet e inspektimit ne juridiksionin e institucioneve qendrore kryhen nga inspektoratet shtetërore, qe janë institucione qendrore publike, nen mbikëqyrjen e ministrit përgjegjës. Si rregull, një inspektorat shtetëror është përgjegjës për te gjitha funksionet e inspektimit ne fushën shtetërore te veprimtarisë te një ministrie.
2. Përtjashtimisht një inspektorat shtetëror mund te jete pjese përbërëse e një institucioni tjetër ne varësi te një ministrie, nëse parashikohet shprehimisht nga një ligji i posaçëm.
3. Inspektorati shtetëror ushtron juridiksionin e tij territorial ne te gjithë territorin e vendit. Nëse është e nevojshme Inspektorati mund te organizohet edhe ne degë territoriale te cilat drejtohen nga inspektori shef i degës përkatëse.

Neni 13

Krijimi dhe Organizimi i inspektorateve shtetërore

1. Përveç se kur parashikohet drejtpërdrejte ne ligj, inspektorati shtetëror kompetent për ushtrimin e një funksioni inspektimi te parashikuar me ligj, krijohet apo përcaktohet nga Këshilli i Ministrave.
2. Këshillit te Ministrave përcakton gjithashtu varësinë institucionale, rregullat e organizimit e funksionimit si dhe numrin dhe juridiksionin territorial te degëve te inspektoratit shtetëror. Inspektoratet e një dege territoriale mund te kryejnë inspektime ne kuadër te një dege tjetër territoriale vetëm me urdhër te posaçëm te Kryeinspektorit.

Neni 14

Drejtimi i inspektorateve shtetërore

1. Çdo inspektorat shtetëror, drejtohet nga Kryeinspektori. Ne rastin kur inspektorati është pjese e një institucioni varësie, kryeinspektor është vete titullari i institucionit te varësisë.
2. Ne kryerjen e detyrave te tij, Kryeinspektori mund te mbështetet nga një apo disa Zëvendës/Kryeinspektorë.
3. Kryeinspektori emërohet dhe lirohet nga detyra nga Kryeministri, me propozim te ministrit përgjegjës. Këshilli i Ministrave miraton kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen, emërimin, vlerësimin e rezultateve ne pune, disiplinën dhe lirimin nga detyra te Kryeinspektorit.

Neni 15

Përgjegjësitë e Kryeinspektorit

1. Kryeinspektori drejton veprimtarinë e Inspektoratit dhe përfaqëson atë ne marrëdhënie me te tretet.
2. Kryeinspektori është përgjegjës për organizimin dhe koordinimin e funksionimit te Inspektoratit dhe për cilësinë dhe eficienten e veprimtarisë se inspektimit.

Seksioni 2

Inspektoratet ne juridiksionin e njësive te qeverisjes vendore

Neni 16

Inspektoratet ne juridiksionin e njësive te qeverisjes vendore

1. Përveç se kur parashikohet drejtpërdrejte ne ligj, njësia qe kryen funksionin e inspektimit te parashikuar me ligj, ne juridiksionin e qeverisjes vendore krijohet apo përcaktohet nga këshilli i njësisë vendore përkatëse.
2. Njësia e inspektimit (këtej e tutje: “inspektorati vendor”) drejtohet nga Kryeinspektori. Neni 15 me sipër, zbatohet edhe për kryeinspektorin vendor.

Seksioni 3

Inspektorati i Qendror

Neni 17

Inspektorati i Qendror

1. Krijohet Inspektorati Qendror, si një institucion publik qendror, me seli ne Tirane dhe ne varësi te Kryeministrit.
2. Inspektorati Qendror financohet nga buxheti i shtetit.
3. Këshilli i Ministrave miraton rregullat e hollësishme te organizimit e funksionimit te Inspektoratit Qendror dhe mënyrën e ushtrimit te funksioneve e te tij sipas këtij ligji.

Neni 18

Misioni dhe funksionet e Inspektoratit Qendror

1. Inspektorati Qendror ka për mision përmirësimin e efciences, efektivitetit dhe përgjegjshmërisë te veprimtarive te inspektimit ne Republikën e Shqipërisë.
2. Inspektorati i Qendror ka këto funksione:
 - a. koordinon dhe bashkërendon veprimtaritë e inspektorateve;
 - b. jep mendim këshillimor për programet e inspektimit te hartuara nga inspektoratet shtetërore apo ato vendore;
 - c. nxjerr rregulla përgjithshme dhe te detyrueshme për inspektoratet lidhur me metodologjinë e vlerësimit te riskut, planifikimin e inspektimeve,

- metodologjinë, teknikat dhe dokumentimin e veprimtarisë së inspektimit si dhe raportimin vjetor të veprimtarisë së inspektorateve;
- d. miraton treguesit e përgjithshëm të efciences, efektivitetit dhe cilësisë veprimtarisë së inspektimit si dhe kriteret e vlerësimit të tyre;
 - e. bën interpretime dhe nxjerr udhëzime për zbatimin e unifikuar të dispozitave procedurale të veprimtarive të inspektimit;
 - f. mbikëqyr zbatimin e këtij ligji dhe ligjit të posaçëm nga inspektoratet dhe inspektorët shtetërorë apo vendore, lidhur me programimin, autorizimin dhe kryerjen e procedimeve të inspektimit dhe ka të drejtë të propozojë marrjen e masave disiplinore ndaj inspektoreve dhe kryeinspektorit, në rast të konstatimit të shkeljeve prej këtyre të fundit;
 - g. jep mendime për çdo nismë ligjore dhe nënligjore në fushën e inspektimit;
 - h. vlerëson punën e inspektorateve shtetërore dhe vendore dhe i paraqet Këshillit të Ministrave raportin vjetor të përgjithshëm të inspektimeve;
 - i. krijon dhe mban një portal unik të inspektimit që shërben për planifikimin dhe koordinimin e inspektimeve si dhe shkëmbimin e të dhënave të nevojshme ndërmjet inspektorateve të ndryshme si dhe për informimin e publikut;
 - j. mban dhe bën publike listën e inspektoreve në detyrë për çdo inspektorat;
2. Në rastin e propozimit të një mase disiplinore ndaj një inspektori apo kryeinspektori, kryeinspektori apo organi epror i kryeinspektorit përkatës është i detyruar të fillojë, pa vonese, procedimin disiplinor.
3. Për realizimin e funksioneve të tij, Inspektorati Qendror ka të drejtë të kërkojë të gjithë informacionin e nevojshëm mbi veprimtarinë e inspektorateve, të inspektojë dosjet e inspektimit si dhe çdo dokument tjetër të lidhur me programimin dhe kryerjen e procedimeve administrative të inspektimit. Inspektorati Qendror nuk duhet të ndikojë në zhvillimin e procedimit dhe vendimmarrjen përkatëse për një rast konkret.

Neni 19

Drejtimi dhe statusi i punonjësve të Inspektoratit të Qendror

1. Inspektorati Qendror drejtohet nga Inspektori i Përgjithshëm që emërohet dhe shkarkohet nga detyra nga Kryeministri.

2. Marrëdhëniet e punësimit të nëpunësve të Inspektoratit të Qendror, me përjashtim të punonjësve të thjeshtë që kryejnë detyra të karakterit mbështetës, rregullohen sipas dispozitave të parashikuara në legjislacionin për nëpunësin civil për institucionet e pavarura, përveç sa parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë ligj. Inspektori i Përgjithshëm është “eprori direkt” i nëpunësve të Inspektoratit, në kuptimin e këtyre dispozitave.

Seksioni 4

Mbikëqyrja dhe raportimi i inspektorateve

Neni 20

Mbikëqyrja dhe raportimi i inspektorateve shtetërore

1. Ministria përgjegjëse mbështet funksionimin efektiv dhe eficient të inspektoratit shtetëror në varësi të tij. Kjo përgjegjësi nuk përfshin drejtimin operacional të veprimtarisë të inspektimit.
2. Ministria përgjegjëse, me mbështetjen e Inspektoratit Qendror përcakton për çdo periudhë në vazhdim:
 - a. objektivat vjetor dhe afatmesëm strategjik të inspektoratit dhe
 - b. treguesit e specifik të efciencës, efektivitetit dhe cilësisë së veprimtarisë së inspektimit dhe punës së inspektorateve.
3. Inspektorat shtetëror i paraqet ministrit përgjegjës dhe Inspektoratit Qendror raportin vjetor të Inspektimit.
4. Ministri përgjegjës ka, gjithashtu të drejtë të kërkojë raporte, informacione dhe dokumente lidhur me menaxhimin e institucional dhe financiar të institucionit dhe me veprimtarinë e inspektimit në përgjithësi apo lidhur me çështje konkrete.
5. Ministri mund të urdhërojë me shkrim dhe në mënyrë të motivuar fillimin e një inspektimi mbi një subjekt të caktuar apo një çështje konkrete që përfshin më shumë se një subjekt.
6. Pikat 1-5 me sipër, zbatohen me *mutatis mutandis* për inspektoratet vendore dhe të drejtat dhe detyrimet e parashikuara për ministrinë apo ministrin përgjegjës ushtrohen nga organi ekzekutiv i njësisë së qeverisjes vendore përkatëse.

Seksioni 5
Statusi i inspektorit

Neni 21
Statusi i inspektorit

1. Marrëdhëniet e punësimit të inspektoreve të inspektorateve shtetërore dhe atyre vendore, rregullohen sipas dispozitave të parashikuara në legjislacionin për nëpunësin civil për institucionet e pavarura, përveç sa parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë ligj. Kryeinspektori i inspektoratit përkatës është “eprori direkt” i nëpunësve në kuptimin e këtyre dispozitave.
2. Kërkesat e veçanta lidhur me arsimimin për punësimin si inspektor miratohen nga Inspektori i Përgjithshëm.
3. Pika 1 me sipër zbatohet edhe për nëpunësit e tjerë që nuk janë inspektore në inspektoratet shtetërore, me përjashtim të punonjësve që kryejnë detyra të karakterit mbështetës, të cilët nënshtrohen legjislacionit të punës dhe legjislacionit tjetër, me zbatim të përgjithshëm në administratën publike.

Neni 22
Çertifikimi i inspektoreve

1. Inspektorët shtetëror dhe vendore i nënshtrohen certifikimit profesional përpara konfirmimit në përfundim të periudhës së provës dhe në mënyrë periodike. Certifikimi profesional në periudhë prove dhe ai periodik bëhet në bazë të një testimi që organizohet nga Inspektorati Qendror.
2. Mos certifikimi deri në përfundim të periudhës së provës apo mos certifikimi periodik, për shkak që varen nga vete inspektori shkakton mos-konfirmimin në fund të periudhës së provës apo përkatësisht largimin nga detyra.
3. Këshilli i Ministrave përcakton periudhën e certifikimit periodik dhe rregullat e hollësishme për procedurën e certifikimit të inspektoreve.

Neni 23
Kryerja e veprimeve të inspektimit nga inspektori në periudhë prove

1. Inspektori ne periudhe prove mund te kryeje veprime inspektimi vetëm nen mbikëqyrjen e një inspektori te certifikuar.
2. Inspektori i certifikuar mbikëqyr veprimet e inspektorit ne periudhe prove dhe nënshkruan çdo akt te tij. Nënshkrimi është kusht për vlefshmërinë e aktit.

Neni 24

Papajtueshmëritë gjate ushtrimit te detyrës dhe ndalime ne mbarim te funksionit

1. Inspektori nuk mund te zotëroje apo kryeje asnjë veprimtari te natyrës tregtare, ekonomike apo profesionale dhe nuk mund të punësohet, me kohë të pjesshme apo të plotë ne subjekte qe kryejnë te tilla veprimtari ne fushën ku inspektori kryen inspektime, me përjashtim te veprimtarive me karakter shkencor apo mësimdhënës.
2. Ndalimi i parashikuar ne piken 1 është i vlefshëm edhe për një periudhe 2 vjeçare pas largimit nga detyra e inspektorit.

KREU IV

RREGULLA TE PËRGJITHSHME PËR PROGRAMIMIN DHE AUTORIZIMI E INSPEKTIMIT

Neni 25

Inspektimi i programuar

1. Një inspektim konkret autorizohet, si rregull, ne baze te programit te inspektimit.
2. Programimi i inspektimi hartohet nga inspektorati bazuar metodologjitë e vlerësimit te rrezikut dhe ne detyrimin për inspektimin periodik ne rastet e parashikuara nga ligji i posaçëm.
3. Programi i inspektimit miratohet nga ministri përgjegjës për inspektoratet shtetëror dhe nga organi ekzekutiv i njësisë se qeverisjes vendore për inspektoratet vendore, pas marrjes se mendimit këshillimor nga Inspektorati Qendror.

Neni 26

Inspektimi i jashtë programit

1. Përgjithësisht, një inspektim konkret mund të autorizohet jashtë programit të inspektimit në këto raste:
 - a. subjekti i inspektimit që detyrohet të paraqesë një informacion periodik sipas ligjit të posaçëm, nuk e ka përmbushur këtë detyrim brenda afatit të caktuar, nuk e ka përmbushur në mënyrë të plote, apo ka dyshime të arsyeshme për vërtetësinë e informacionit të paraqitur;
 - b. nga monitorimi dhe mbikëqyrja e kryer nga inspektoratet nëpërmjet analizës periodike dhe të vazhduar të dhënave apo informacioneve, lind dyshimi i arsyeshëm për shkeljen e kërkesave ligjore; se është i nevojshëm fillimi i një inspektimi;
 - c. si pasojë e informacionit të dërguar nga një institucion tjetër publik, konsiderohet se është i nevojshëm fillimi i një inspektimi;
 - d. ndodhjes së ngjarjeve, aksidenteve apo incidenteve që kanë apo mund të cenojnë jetën apo shëndetin e njerëzve, kafshëve apo mjedisin,
 - e. parashikohet në pikën 5 të nenit 20 me sipër, dhe
 - f. parashikohet shprehimisht nga ligji i posaçëm;
2. Një inspektim jashtë programit mund të autorizohet edhe në bazë të një denoncimi apo informacioni të marrë nga të tjerët kur krijohet dyshimi i arsyeshëm për shkelje të kërkesave ligjore nga një subjekt.
3. Personi që ka paraqitur denoncimin apo informacionin sipas pikës 2 me sipër, informohet në përfundim të procedimit të inspektimit mbi rezultatet e tij por nuk është pale e procedimit të inspektimit në kuptimin e Kodit të Procedurës Administrative.
4. Inspektim jashtë programit do të konsiderohet edhe inspektimi në kushtet e “flagrancës” sipas parashikimit të germës “a” të pikës 2 të nenit 28 me poshtë.

Neni 27

Kohëzgjatja vjetore e inspektimit në vendin e ushtrimit të veprimtarisë

1. Gjate një viti kalendarik një subjekt i caktuar, inspektimi, nuk mund të nënshtrohet inspektimeve në vend, në fushën e veprimit të këtij ligji, për një periudhë kohore me të gjatë se periudha maksimale e lejuar e inspektimit vjetor.
2. Këshilli i Ministrave përcakton periudhën maksimale të lejuar të inspektimeve vjetore për kategori të ndryshme të subjekteve të inspektimit në varësi të madhësisë së subjektit dhe rrezikut të veprimtarisë që kryhet, si dhe mënyrën e llogaritjes së saj. Periudha maksimale e lejuar e inspektimit vjetor është nga 5 deri në 20 dite.

3. Ne llogaritjen e periudhës maksimale të lejuar, nuk përfshihen:
 - a. inspektim rastësor;
 - b. inspektimi i parashikuar në shkronjën “d” të pikës 1 të nenit 26 me sipër;
 - c. inspektimi për verifikimin e korigjimit të shkeljeve në përfundim të afatit të përcaktuar në pikën 6 të nenit 52 me poshtë të këtij ligji.

Neni 28

Autorizimi i një inspektimi

1. Procedimi administrativ i inspektimit fillon, si rregull, me lëshimin e autorizimit të inspektimit (këtëj e tutje: “autorizimi”) nga kryeinspektori. Në rastin e inspektorateve shtetërore të organizuara me dege territoriale, e drejta e autorizimit mund të delegohet inspektorit shef të degës territoriale.
2. Inspektimi mund të fillojë, pa një autorizim sipas pikës 1 me sipër, vetëm në këto raste:
 - a. konstatimit në flagrancë nga inspektori, në mënyrë të rastësishme dhe gjatë orarit zyrtar të punës të shkeljes të një kërkese ligjore, brenda fushës së tij të inspektimit;
 - b. inspektimit sipas shkronjës “d” të pikës 1 të nenit 26 me sipër, dhe
 - c. inspektimi i parashikuar në ligjet e posaçme që kryhet në pikat e kalimit të kufirit.
3. Fillimi i inspektimit në rastin e parashikuar në shkronjën “a” dhe “b” të pikës 2 me sipër, pasqyrohet menjëherë me një shënim në një rubrikë të posaçme të procesverbalit të inspektimit që konsiderohet si autorizim i posaçëm i inspektimit. Inspektori detyrohet të njoftojë, pa vonesë, personin përgjegjës për lëshimin e autorizimit të inspektimit.
4. Autorizimi nuk mund të ankimohet veçmas vendimit përfundimtar të inspektimit.

Neni 29

Autorizimi i paligjshëm i një inspektimi

1. Lëshimi i autorizimit në kundërshtim me nenin 25-28 me sipër të këtij ligji, nuk përben veçmas, shkak për pavlefshmërinë e vendimit përfundimtar të inspektimit por përben shkelje disiplinore për personin përgjegjës për lëshimin e autorizimit.

Neni 30

Përmbajtja e Autorizimit

1. Autorizimi i inspektimit përmban të paktën këto elemente:

- a. inspektoratin shtetëror apo vendor përkatës;
 - b. objektin e inspektimit;
 - c. bazën ligjore;
 - d. datën dhe vendin e lëshimit;
 - e. identitetin e inspektorit apo inspektoreve të autorizuar për të kryer inspektimin, numri i unik i identifikimit të tyre;
 - f. identitetin e personave të tjerë të autorizuar për kryerjen e veprimeve ndihmëse, sipas pikës 1 të nenit 33 me poshtë të këtij ligji;
 - g. emrin/emërtimin dhe adresën e subjekti të inspektimit apo të dhëna për përcaktimin e tij në rastin e inspektimit rastësor;
 - h. datën e fillimit dhe afatin në ditë për kryerjen e inspektimit;
 - i. vendin apo vendet ku do të kryhet inspektimi;
 - j. të dhënat e identifikimit, pozicionin dhe nënshkrimin e personit që ka lëshuar autorizimin;
2. Në rastin që emri, emërtimi apo adresa e subjektit të inspektimit nuk janë të ditura, autorizimi përmban shpjegim të detajuar që lejon përcaktimin sa më të sakte të subjektit të inspektimit.
 3. Përmbajtja e detajuar e autorizimit për çdo funksion inspektimi, miratohet nga Inspektori i Përgjithshëm me propozim të kryeinspektorit përkatës.

Neni 31

Afati i autorizimit

1. Autorizimi është i vlefshëm vetëm për afatin e përcaktuar shprehimisht në të.
2. Përveç se kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji i posaçëm, në raste të përjashtimore, për shkak të kompleksitetit të veprimeve të inspektimit afati mund të zgjatet me një herë të vetme dhe për një periudhë të jo më të gjatë se afati fillestar.
3. Zgjatja bëhet me propozim të inspektorit dhe vendim të personit përgjegjës për lëshimin e autorizimit. Vendimi i zgjatjes së afatit i njoftohet subjektit të inspektimit përpara kalimit të afatit të përfundimit dhe nuk mund të ankimohet veçmas.
4. Çdo veprim procedural i kryer jashtë afatit të parashikuar sipas pikave 1 dhe 2 me sipër, nuk prodhon asnjë pasoje juridike mbi subjektin e inspektimit dhe ngarkon me përgjegjësi disiplinore inspektorin përkatës.
5. Inspektimi që zgjat më pak se katër ore llogaritet si inspektim gjysme ditor, ndërsa ai që zgjat më shumë se katër ore llogaritet si inspektim 1 ditor.

KREU V

PROCEDURA E INSPEKTIMIT

Seksioni 1

Njoftimi i inspektimit dhe nëpunësit pjesëmarrës ne inspektim

Neni 32

Personat e autorizuar për te kryer veprime inspektimi

1. Inspektimi kryhet nga inspektorët e parashikuar ne autorizimin e inspektimit.
2. Përveç kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji i posaçëm vetëm inspektorët sipas pikës 1, mund te kryejnë veprime inspektimi dhe gëzojnë te drejtat dhe mbartin detyrimet e parashikuar ne këtë ligj.
3. Zëvendësimi i një inspektori te përcaktuar ne autorizimin e inspektimit, mund te behet vetëm me vendim te veçante te personit përgjegjës për lëshimin e autorizimit, qe i njoftohet pa vonese subjektit te inspektimit dhe sidoqoftë përpara fillimit te veprimeve nga inspektori i ri. Vendimi i zëvendësimit te inspektorit nuk mund te ankimohet veçmas.
4. Gjate ushtrimit te veprimtarisë Inspektuese, Inspektori identifikohet me kartën e inspektorit. Karta e inspektorit leshtohet nga Inspektorati Qendror për inspektoratet shtetërore apo nga organi ekzekutiv i qeverisjes vendore për inspektimet ne juridiksionin e tyre.

Neni 33

Mbështetja e veprimeve te inspektimit

1. Gjatë veprimtarisë se inspektimit, inspektori mund t'i kërkojë institucioneve shtetërore apo eksperteve publike ose private qe ta ndihmojnë për përcaktimin e fakteve dhe rrethanave te nevojshme për marrjen e një vendimi.
2. Veprime te caktuara ndihmese, gjate inspektimit mund te kryhen, gjithashtu edhe nga nëpunës te tjerë te organit inspektues qe nuk janë inspektore .
3. Nëpunësit apo ekspertet e përcaktuar ne piken 1 dhe 2 me sipër, nuk kane te drejtat e përcaktuara nga ky ligj për inspektorin dhe nuk mund te kryejnë veprime inspektimi apo te marrin vendime procedurale apo përfundimtare lidhur me inspektimi. Nëse mbështetin

inspektoret gjate kryerjes se inspektimit ata duhet te përcaktohen shprehimisht ne autorizimin e inspektimit apo ne një akt te posaçëm te nxjerre nga lëshuesi i autorizimit.

Neni 34

Njoftimi i inspektimit

1. Inspektimi njoftohet nëpërmjet njoftimit paraprak te autorizimit, subjektit te inspektimit jo me vone se 3 dite përpara fillimit te veprimeve te inspektimit. Njoftimi paraprak nuk kryhet ne këto raste:
 - a. ekziston rreziku qe njoftimi mund te pengoje kryerjen me efektivitet te inspektimit;
 - b. mos-njoftimi përcaktohet shprehimisht nga ligji i posaçëm;
 - c. ne inspektimin për verifikimin e korrigjimit te shkeljeve ne përfundim te afatit te përcaktuar sipas pikës 6 te nenit 52 me poshtë te këtij ligji.;
 - d. ne inspektimet e parashikuara ne piken 2 te nenit 28 me sipër te këtij ligji.
2. Mos njoftimi i inspektimit, sipas shkronjës “a” te pikës 1 me sipër, vendoset nga personi qe lëshon autorizimin dhe pasqyrohet ne autorizim.
3. Ne rast te mos-njoftimit paraprak, inspektimi njoftohet njëkohësisht me fillimin e veprimeve te inspektimit:
 - a. nëpërmjet dorëzimit te autorizimit përfaqësuesit te subjektit te inspektimit ne rastet e parashikuar ne shkonjen “a”-“c” te pikës 1 me sipër. Ne rast te refuzimit te marrjes se autorizimit apo mos gjetjes se personit përfaqësues, inspektori e afishon autorizimin ne vendin ku kryhet inspektimi dhe ky fakt pasqyrohet ne procesverbal
 - b. nëpërmjet njoftimit verbal ne rastet e tjera;
4. Pavarësisht njoftimit paraprak, inspektori përpara fillimit te veprimeve te inspektimit informon, verbalisht, përfaqësuesin e subjektit te inspektimit mbi objektin e inspektimit si dhe te drejtat dhe detyrimet e subjektit te inspektimit sipas ligjit dhe pasojat ligjore te mosrespektimit te këtyre detyrimeve.

Neni 35

Vendi i inspektimit

1. Vendi i inspektimit përcaktohet në autorizim. Vendi i inspektimit mund te jete:
 - a. kudo ku kryen veprimtarinë e tij subjekti i inspektimit, apo ndodhen faktet qe për respektimin apo mosrespektimin e kërkesave ligjore;

- b. nëse është e mundur nga natyra e inspektimi, inspektimi mund të kryhet në zyrat e organit inspektues.
2. Në rastin e parashikuar në germën “b” të pikës 1 me sipër, subjekti i inspektimit ftohet të paraqitet në zyrat e Inspektoratit. Nëse është e nevojshme inspektori mund të kërkojë paraqitjen e dokumenteve, sendeve apo mostrave të nevojshme për kryerjen e inspektimit në zyrat e tij.

Neni 36

Koha për kryerjen e Inspektimit

1. Përveç kur parashikohet ndryshe nga ligji i posaçëm, veprimet e inspektimit zhvillohen në kohën që është me e përshtatshme për kryerjen me efektivitet të tyre, pavarësisht orarit normal të punës të inspektorit apo subjektit të inspektimit.
2. Kur inspektimi në vend, nuk mund të përfundojë brenda orarit normal të punës, nëse e nevojshme, inspektori mund të vendosë ndalimin e hyrjes në ambientet nën inspektim apo dyllosjen e makinerive, pajisjeve dokumenteve të caktuara, për periudhën e ndërprerjes së veprimeve të inspektimit, deri në rifillimin normal të tyre por jo për më shumë se 2 ditë.
3. Vendimi sipas pikës 2 me sipër, pasqyrohet në procesverbalin e inspektimit dhe i njoftohet verbalisht përfaqësuesit të subjektit të inspektimit. Vendimi nuk mund të ankimohet veçmas.

Seksioni 2

Te drejtat dhe detyrimet e subjektit të inspektimit

Neni 37

Te drejtat e subjektit të inspektimit

1. Subjekti i inspektimit ka këto të drejta gjatë inspektimit:
 - a. të kërkojë të njihet me autorizimin inspektimit, përveç rasteve kur sipas ligjit inspektimi nuk bëhet në bazë të autorizimit.;
 - b. të kërkojë identifikimin inspektoreve nëpërmjet kartës së inspektorit;
 - c. të jetë prezent dhe të ndjeke, nëpërmjet përfaqësuesit të tij, të gjithë veprimet e inspektimit;
 - d. të kërkojë dhe marrë informacion nga inspektori mbi procedurën e inspektimit dhe çdo veprim apo vendim të ndërmarre gjatë saj;

- e. te paraqesë mendimet, shpjegimet mbi faktet, rrethanat apo edhe çështjet ligjore qe kane te bëjnë me procedimin përkatës apo te paraqesë propozimet e tij për zgjidhjen e çështjes si dhe te bashkëngjisë dokumentet përkatëse ku i mbështet ato.
 - f. te kërkoje te njihet dhe ti njoftohet procesverbali i inspektimit;
 - g. te paraqesë komentet e tyre mbi vlerësimin e provave te administruara, rezultatet e hetimit dhe vendimin qe synohet te merret nga organi publik.
 - h. te refuzoje çdo kërkesë te inspektorit jashtë objektit te inspektimit sipas përcaktimit te autorizimit përkatës apo qe tejkalon te drejtat e inspektorit sipas këtij ligji dhe ligjit te posaçëm.
2. Ne rast se prezenca gjate kryerjes se inspektimit, sipas shkronjës “c” te pikës 1 me sipër, pengon kryerjen e veprimeve te inspektimit, inspektori mund te vendose përjashtimin nga pjesëmarrja. Vendimi pasqyrohet ne procesverbal dhe nuk mund te ankohet veçmas.

Neni 38

Detyrimet e subjektit te inspektimit

1. Përveç sa parashikohet nga ligji i posaçëm, subjekti i inspektimit ka këto detyrime gjate veprimtarisë se inspektimit:
- a. te caktoje një përfaqësues për te komunikuar me inspektorin gjate inspektimit;
 - b. te lejoje dhe mos-pengoje kryerjen e veprimeve te inspektimit;
 - c. te ndaloje kryerjen e plote apo te pjesshme te veprimtarisë nëse kjo është nevojshme për zhvillimin normal te veprimtarisë se inspektimit dhe kërkohet nga inspektori;
 - d. nëse inspektimi kryhet ne vendin e ushtrimit te veprimtarisë, te siguroje një vend te përshtatshëm për punën e inspektorit.
 - e. te paraqesë çdo informacion, dokument dhe te japë çdo shpjegim lidhur me faktet dhe rrethanat e konstatuara apo te nevojshme për inspektimin, nëse kërkohet nga inspektori dhe brenda afateve te përcaktuara nga ai;
 - f. te lejoje dhe mundësoje marrjen e dëshmive nga punëmarrësit e tij, nëse kjo kërkohet nga inspektori;

Seksioni 3

Te drejtat dhe detyrimet e inspektorit

Neni 39

E drejta e hyrjes dhe inspektimit ne ambientet e veprimtarisë subjektivit te inspektuar

1. Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji i posaçëm, inspektori ka te drejte te hyje dhe te inspektojë godinat, ambientet, objektet, mjetet e transportit ku apo nëpërmjet te cilave ushtron veprimtarinë subjektivit i inspektimit si dhe te inspektojë instalimet, pajisjet, makineritë, produktet, sendet, substancat, përbërësit dhe çdo send tjetër te lidhur me veprimtarinë objekt inspektimi;
2. Hyrja dhe inspektimi sipas pike 1 behet pa pasur nevojë për lejen e subjektivit te inspektuar. Ne rast pengimi, hyrja dhe inspektimi mund te behet edhe me force. Shpenzimet e nevojshme për realizimin e hyrjes me force, i ngarkohen subjektivit te inspektimit dhe përcaktohen ne procesverbal apo ne vendimin përfundimtar.

Neni 40

Shtirja e inspektimit ne ambientet e banimit te subjektivit te inspektimit

1. Inspektori mund kërkojë te lejohet te shtrijë inspektimin ne banesën e subjektivit te inspektimit, dhe ambiente qe njësohen me te, ne rast se ka dyshime te arsyeshme qe ne to kryhet nga subjektivit inspektimi veprimtari ne kundërshtim me kërkesat ligjore, objekt inspektimi. Hyrja ne këto ambiente mund te behet vetëm me lejen e subjektivit te inspektimit.
2. Ne rast refuzimi, hyrja mund te behet vetëm ne baze te një vendim gjykate. Gjykata kompetente për lëshimin e urdhrit te inspektimit ne banesa apo ambientet e njësuar me to është gjykata kompetente për zgjidhjen e mos-marrëveshjeve administrative ne juridiksionin te cilës ndodhet banese për te cilën kërkohet inspektimit.
3. Gjykata vendos ne brenda 24 orëve nga paraqitja e kërkesës nga inspektori. Kundër vendimit te gjykatës mund te paraqitet ankim i veçante sipas dispozitave te Kodit te Procedurës Civile.

Neni 41

Shtirja e inspektimit ne ambientet qe nuk i përkasin subjektivit te inspektimit

1. Nëse ka dyshime te arsyeshme se subjektivit i inspektimit kryen veprimtari apo veprime, apo pasojat e veprimeve te tij kryhen/shtrihen ne ambientet ne pronësi apo ne përdorim te një personi fizik apo juridik, pronari apo përdoruesi i këtyre ambienteve, me kërkesë te inspektorit, detyrohet te lejojë shtirjen e inspektimit ne ambientet e tij.

2. Pronari apo përdoruesi, sipas pikës 1 me sipër, mund të refuzojë shtrirjen e inspektimit në ambientet e tij, vetëm në këto raste:
 - a. ambienti është banesë apo ambient i njehsuar me të;
 - b. inspektimi mund të shkaktojë një cenim të rëndë moral apo pasuror të tij apo të çojë në ndjekjen penale të tij apo familjareve të tij deri në shkallën e dytë;
 - c. lejimi i inspektimit mund të çojë në cenimin e sekretit profesional që ka detyrimin të mbrojtë sipas legjislacionit në fuqi.
3. Nëse personi, refuzon lejimin e inspektimit në raste të tjera përveç atyre të parashikuara në pikën 2 me sipër, hyrja në këto ambiente bëhet me forcë në prezencën e personit apo përfaqësuesit të tij.
4. Nëse shtrirja e inspektimit pengohet, apo personi nuk mund të gjendet a identifikohet dhe ekziston rreziku që provat mund të zhvendosen, prishen apo ndryshohen përpara inspektimit, inspektori mund të bllokojë ambientin deri në kryerjen e inspektimit. Masa e bllokimit merret nëpërmjet një vendimi të ndërmjetëm për këtë qëllim. Pronaret apo përdoruesit kanë të drejtën e ankimit të veçantë.

Neni 42

Marrja e mostrave

1. Nëse është e nevojshme për qëllimin e inspektimit, inspektorët kanë të drejtën të marrin mostra të produkteve, materialeve, mallrave, substancave apo prodhimeve dhe t'ja nënshtrijnë ato ekzaminimit apo analizave.
2. Mostrat merren në prani të përfaqësuesit të subjektit të inspektuar përveç rasteve kur ai është përjashtuar, me vendim, nga të qenit prezent gjatë inspektimit. Përpara zgjedhjes së mostrave inspektori i shpjegon përfaqësuesit procedurën e marrjes së tyre.
3. Inspektori mund të marrë mostra në sasinë e nevojshme për kryerjen e ekzaminimit apo analizave dhe për të siguruar përsëritjen e tij nëse është e nevojshme.
4. Marrja e mostrave pasqyrohet në procesverbalin e inspektimit. Inspektori është i detyruar të njoftojë rezultatet e ekspertizës brenda 2 ditëve nga përfundimi i tyre.
5. Shpenzimet për përzgjedhjen, transportin dhe ekzaminimin e analizën e mostrave, përballohen nga subjekti i inspektimit, vetëm nëse rezultati i ekzaminimit apo analizave provon shkeljen e kërkesave ligjore përkatëse. Shuma e shpenzimeve pasqyrohet në vendimin përfundimtar të inspektimit.
6. Këshilli i Ministrave miraton procedurën e detajuar të marrjes së mostrave sipas tipit të inspektimit dhe metodologjinë e llogaritjes së shpenzimeve.

Neni 43

Marrja e kopjeve dhe sekuestrimi i dokumenteve

1. Gjate inspektimit, inspektori ka te drejte te kërkoje dhe marre kopje te dokumenteve te veprimtarisë ne përputhje me objektin e inspektimit. Kërkesa behet me goje dhe pasqyrohet ne procesverbalin e inspektimit. Çdo kopje dokumenti, i marre, nënshkruhet nga përfaqësuesi i subjektit te inspektuar
2. Inspektori ka gjithashtu te drejtën te sekuestroje dokumente me qellim verifikimin e autenticitetit apo korektesise se informacionit. Vendimi i sekuestrimit te dokumenteve pasqyrohet procesverbalin e inspektimit dhe përmban përshkrimin e plote te dokumenteve te sekuestruara. Subjekti ka te drejtën te beje me shpenzimet e tij fotokopje te dokumenteve te sekuestruar.
3. Pikat 1 deri 3 me sipër zbatohen edhe për dokumentet e ruajtura ne trajte elektronike, regjistrimet elektronike e audio-vizive apo te çfarëdo tipi teknologjie tjetër.

Neni 44

Detyrimi i te tretëve për te dëshmuar

1. Çdo person, qe nuk është subjekt i inspektimit por që është në dijeni të fakteve të nevojshme për procedimin administrativ te inspektimit, me kërkesë te inspektorit, detyrohen te dëshmojë brenda 3 ditëve nga marrja e kërkesës se inspektorit.
2. Përrjashtohen nga detyrimi sipas pikës 1, me sipër, anëtarët e familjes se subjektit te inspektimit, personat qe kane detyrimin për te ruajtur sekretin profesional për faktet qe kane marre dijeni gjate veprimtarisë se tyre normale profesionale si dhe çdo person tjetër kur dëshmia e tij mund ta ekspozoje atë apo familjaret e shkalles se dyte ndaj ndjekjes penale.

Neni 45

Te drejtat te tjera te inspektorit

Përveç sa parashikohet me sipër, ne këtë seksion, inspektori, brenda objektit dhe qëllimit te inspektimit, ka edhe këto te drejta:

- a. te kryejë fotografime, filmime apo regjistrime ne çdo mënyre tjetër teknike, te mjediseve, instalimeve, proceseve te punës dhe godinave, ambienteve, objekteve, mjeteve te transportit, instalimeve, pajisjeve, makinerive, produkteve, sendet, substancave, përbërësve dhe çdo sendi tjetër te lidhur me veprimtarinë e subjektit te inspektimit;

- b. te inspektoje çdo dokument apo regjistrim te nevojshëm për verifikimin e respektimit te kërkesave ligjore, përfshire edhe te ato te ruajtura, krijuar apo mbajtura ne format elektronik apo çdo teknike tjetër;
- c. te beje matjet e nevojshme për te verifikuar respektimin e kërkesave ligjore nga subjekti i inspektimit;
- d. te kryej verifikime te dokumenteve lidhur me identitetin e personave nëse kjo është e nevojshme sipas objektit te inspektimit;
- e. t'i kërkojë subjektit të inspektimit apo punëmarrësit e tij te kryejnë të gjithë veprimet e nevojshme për te lehtësuar inspektimin;
- f. te vendose aparatura te përhershme apo te përkohshme për monitorimin teknik te veprimtarisë te inspektuar;
- g. te marre pa pagese dhe te përdore për qëllimet e inspektimit, çdo te dhëne mbi subjektin e inspektimit dhe veprimtarinë e tij, nga çdo institucion shtetërore qe i disponon ato;
- h. te administroje çdo mjet tjetër prove sipas Kodit te Procedurave Administrative për përcaktimin e situatës faktike dhe rrethanave te nevojshme për marrjen e një vendimi përfundimtar;

Neni 46

Mbështetja e inspektimit nga policia e shtetit

Nëse inspektori ndesh apo mund te ndesh rezistence fizike, mund te kërkoje ndihmën e policisë se shtetit qe ushtron juridiksionin ne zonën përkatëse. Policia siguron mbështetjen ne përputhje me dispozitat ligjore.

Seksioni 4

Masat Urgjente

Neni 47

Masat Urgjente

1. Inspektori, gjate inspektimit ka te drejte te marre masa urgjente, me vendim te ndërmjetëm ne këto raste:
 - a. për shkak te shkeljes se konstatuar te kërkesave ligjore mund te shkaktohet një dëm i menjëhershëm, i rende dhe i riparueshme interesit publik apo palëve te

treta, veçanërisht nëse është e nevojshëm për të shmangur një rrezik të menjëhershëm për jetën apo shëndetin e njerëzve, kafshëve apo për mjedisin;

- b. ka një dyshim të arsyeshëm për shkelje të kërkesave ligjore që mund të shkaktojnë një dëm të menjëhershëm të rëndë dhe i pariparueshëm interesit publik apo palëve të treta dhe është e nevojshme kryerja e verifikimeve të mëtijshme dokumentare apo kryerja e ekzaminimeve a analizave;

2. Masat urgjente janë:

- a. ndërprerja e kryerjes së një veprimi, veprimtarie apo një pjese të saj;
- b. ndalimi i funksionimit të një instalimi, makinerie apo paisje;
- c. bllokimin dhe ndalimin e hyrjes në ambientet e ushtrimit të veprimtarisë;
- d. bllokimi i kafshëve, bimëve, mallrave, makinerive, produkteve apo sendeve;
- e. ndalimi i përkohshëm i hyrjes në territorin e vendit të kafshëve, bimëve, mallrave, makinerive, produkteve apo sendeve;
- f. urdhërimi i subjektit të inspektimit, të njoftojë të tretët apo publikun për rreziqet e mundshme, si dhe
- g. edhe çdo masë tjetër që vlerësohet e dobishme dhe proporcionale për të realizuar qëllimin e masës urgjente.

3. Në rastin e ndalimit të hyrjes në territorin e vendit sipas shkronjës “d” të pikës 2 më sipër, sendet depozitohen dhe ruhen sipas dispozitave të ligjit të posaçëm apo marrëveshjeve ndërkombëtare;

4. Nëse është e mundur, qëllimi për të marrë një masë urgjente i njoftohet paraprakisht, në mënyrë verbale, përfaqësuesit të subjektit të inspektimit duke i dhënë mundësinë për paraqitur pa vonese, komentet dhe shpjegimet përkatëse.

5. Vendimi i ndërmjetëm për marrjen e masës urgjente, pasqyrohet në procesverbal dhe i njoftohet subjektit, pa vonese, në mënyrë verbale. Një akt i shkruar me të njëjtën përmbajtje i njoftohet brenda 24 orëve.

6. Vendimi i ndërmjetëm përfundon automatikisht me kalimin e afatit të parashikuar në të apo, në rast se nuk është përcaktuar një afat të tillë apo me:

- a. njoftimin e revokimit të tij;
- b. njoftimin e përfundimit të procedimit apo njoftimin e vendimit përfundimtar, që nuk konstaton shkelje të kërkesave ligjore.
- c. skadimin e afatit për njoftimin e vendimit përfundimtar të inspektimit pa një vendim të tillë;

- d. njoftimin e vendimit te zgjidhjes se ankimit ndaj vendimit përfundimtar te inspektimit ne rastin kur është bere ankim, apo
 - e. skadimin e afatit për paraqitjen e ankimit administrativ ndaj vendimit përfundimtar pa bere ankim.
7. Vendimi i ndërmjetëm është me ekzekutim te menjëhershëm. Nëse nuk ekzekutohet vullnetarisht, pa vonese, nga subjekti i inspektimit apo nëse ai bën te ditur apo rezulton nga rrethanat se nuk nuk do te ekzekutoje vendimin, vendimi ekzekutohet menjëherë nga inspektorati përkatës me shpenzimet e subjektit te inspektimit te cilat pasqyrohen ne vendimin përfundimtar.
 8. Masat urgjente mund te merren deri ne momentin e marrjes se vendimit përfundimtar.
 9. Kundër vendimit te masës se urgjente, subjekti i interesuar ka te drejtën e ankimit te veçante sipas nenit 48 me poshtë.

Neni 48

Ankimi i veçantë

1. Ankimi i veçantë mund te paraqitet brenda afatit prej 5 dite nga njoftimit te vendimit te ndërmjetëm dhe nuk pezullon ekzekutimin e tij.
2. Si rregull, ankimi i veçantë, shqyrtohet drejtpërdrejte nga inspektori shef i degës territoriale. Nëse ligji i posaçëm parashikon qe vendimi i ndërmjetëm te merret nga inspektori shef i degës territoriale apo një komision i posaçëm, apo nëse inspektorati nuk ka dege territoriale, ankimi shqyrtohet drejtpërdrejte nga Kryeinspektori.
3. Përveç se kur parashikohet ndryshe nga ligji i posaçëm, ankimi i veçante ne rastin e inspektimeve ne juridiksionin e qeverisjes shqyrtohet drejtpërdrejte nga Kryeinspektori vendor.
4. Vendimi për zgjidhjen e ankimit te veçantë merret dhe njoftohet brenda 4 ditëve nga paraqitja e ankimit.

KREU VI

PROCESVERBALI I INSPEKTIMI DHE VENDIMMARRJA

Neni 49

Hartimi dhe njoftimi i procesverbalit

1. Ne përfundim të veprimeve të inspektimit, inspektori që kryen inspektimin, harton procesverbalin e veprimeve të inspektimit (këtej e tutje: procesverbali). Nëse me shumë inspektore kanë kryer veprimet e inspektimit në baze të një autorizimi të vetëm, ata e hartojnë procesverbalin së bashku. Procesverbali i inspektimit hartohet në tre kopje të cilat nënshkruhen nga inspektori apo inspektoret hartues.
2. Procesverbali hartohet si rregull, në vendin e inspektimit. Nëse kjo nuk është e mundur procesverbali mund të hartohet në zyrat e inspektoratit.
3. Procesverbali përmban informacion të detajuar për veprimet e inspektimit, gjetjet e tij dhe vendimet e mara gjatë inspektimit dhe shoqërohet me liste-verifikimin e plotësuar të gjatë inspektimit. Përmbajtja e hollësishme e procesverbalit përcaktohet nga Këshilli i Ministrave.
4. Nëse procesverbali hartohet në vendin e inspektimit, ai i njoftohet subjektit të inspektimit pa vonese, nëpërmjet dorëzimit, në të kundërt procesverbali njoftohet brenda 3 ditëve nga përfundimi i inspektimit në vendin e inspektimit.

Neni 50

Shqyrtimi dhe vendimi përfundimtar

1. Përveçse kur parashikohet ndryshe nga ligji i posaçëm, vendimi përfundimtar i inspektimit, merret nga inspektori apo inspektoret që kanë kryer inspektimin dhe brenda 10 ditëve nga njoftimi i procesverbalit të inspektimit. Në këtë rast, procesverbali i inspektimit, i hartuar sipas nenit 48 me sipër, duhet të përmbajë dhe informacion mbi të drejtën e subjektit të inspektuar të paraqesë me shkrim apo me gojë komentet e tij mbi faktet dhe rrethanat e konstatuara në procesverbal dhe një afat jo më të shkurtër se 3 dite nga njoftimi i procesverbalit për paraqitjen e tyre. Pas kalimit të afatit vendimi përfundimtar mund të merret pa qene e nevojshëm dëgjimi i mëtejshëm i subjektit të inspektimit.
2. Nëse ligji i posaçëm parashikon që Inspektori duhet të shqyrtojë dhe marrë vendimin përfundimtar si pjesë e procesverbalit, inspektori përpara marrjes së vendimit i shpjegon subjektit të inspektimit shkeljet e konstatuara, nëse ka të tilla, dhe vendim që synon të marrë dhe dëgjon shpjegimet apo komentet e tij të cilat pasqyrohen në procesverbal. Shpjegimi dhe dëgjimi i subjektit nuk është i nevojshëm në rastin kur nuk konstatohen shkelje.
3. Vendimi përfundimtar sipas pikës 2 me sipër është pjesë e procesverbalit.

Neni 51

Përfundimi i procedimit kur nuk konstatohen shkelje

1. Nëse konstatohet se nuk ka shkelje të kërkesave ligjore, procedimi administrativ i inspektimit përfundon me një vendim në fund të procesverbalit apo me vendim përfundimtar, pas shqyrtimit, sipas nenit 50 me sipër.
2. Në vendimin në procesverbal apo vendimin përfundimtar përcaktohen edhe arsyet për përfundimin e procedimit.

Neni 52

Shkelja e kërkesave ligjore nga subjekti i inspektimit

1. Nëse konstatohet shkelje të kërkesave ligjore, që përben kundravajtje administrative por që janë të një rëndësie të vogël apo për të cilat ligji i posaçëm nuk parashikon dënimin përkatës kundravencional, pas shqyrtimit sipas nenit 50 me sipër të këtij ligji, subjekti i inspektimit dënohet me “paralajmërim”. Paralajmërimi është dënim kundravencional kryesor.
2. Subjekti i inspektimit mund të dënohet drejtpërdrejtë me një dënim tjetër kryesor kundravencional, me të rënde, të parashikuar në ligjin e posaçëm, nëse:
 - a. shkelja e konstatuar është e rënde;
 - b. pasojat që kanë ardhura nga shkelja janë të rënda;
 - c. përsërit një shkelje të kërkesave ligjore;
 - d. nuk ka zbaton plotësisht dhe brenda afatit të përcaktuar, urdhërimin e parashikuar në pikën 4 më poshtë të këtij neni.
3. Bashkë me dënimin kryesor mund të jepen edhe dënimet shoqëruese sipas përcaktimit të ligjit të posaçëm. Për të njëjtën shkelje mund të vendoset një dënim kryesor dhe një apo me shumë dënime shoqëruese.
4. Nëse e nevojshme, dënimi kundravencional, shoqërohet me urdhërimin e subjektit të inspektimit të korrigjonte shkeljet e konstatuara dhe të eliminojë pasojat e tyre duke përcaktuar dhe një dhe afat të arsyeshëm për këtë qëllim. Vendimi i dënimit përfshin këshillimin me shkrim të subjektit për mënyrën e korrigjimit të shkeljeve që pasyrohen në një fletë shoqëruese.
5. Në rastin e parashikuar në pikën 4 me sipër, subjekti i inspektimit është i detyruar të njoftojë për korrigjimin e shkeljeve brenda afatit të përcaktuar dhe nëse është e nevojshme të paraqesë edhe provat që vërtetojnë këtë fakt.
6. Për verifikimin e korrigjimit të shkeljeve sipas pikës 4 me sipër, mund të kryhet një inspektim i ri.

7. Mos korrighjimi i parregullsive brenda afatit te përcaktuar përben, veçmas, kundravajtje administrative qe dënohet me dënimin shoqërues, gjobe ne vlerë nga 10 000 deri ne 100 000 Lek.

Neni 53

Shkelje te dispozitave te tjera ligjore jashtë kompetencës se inspektorit

1. Nëse, konstaton shkeljen e një ligji apo akti nënligjor, mbikëqyrja e zbatimit te cilit është nen kompetencën e një trupe tjetër inspektuese, inspektori përcakton faktet qe përbejnë shkelje dhe përgatit një raport te detajuar. Raporti i njoftohet, pa vonese, Inspektoratit kompetent dhe Inspektoratit Qendror qe ka detyrimin te njoftoje inspektoratin kompetent.
2. Nëse, gjate inspektimit konstatohet shkelja e një ligji apo akti nënligjor dhe ekziston dyshimi i arsyeshëm për ekzistencën e elementet e një vepre penale, inspektorati paraqet pa vonese, kallëzim ne organet kompetente te ndjekjes penale.

Neni 54

Njoftimi i te tretëve

1. Nëse shkeljet e konstatuara gjate inspektimit, janë kryer ne mënyre te tille qe cenojnë te drejtat apo interesat e ligjshme te një personi te trete, Inspektorati njofton personin e trete për këtë fakt, gjetjet e inspektimit dhe masat e marra.
2. Nëse e konsideron te nevojshme Inspektorati mund te urdhëroje kryerjen e publikimit te vendimit përfundimtar apo një përmbledhje te tij.

Neni 55

Ankimi ndaj vendimit përfundimtar te inspektimit

1. Ankimi administrativ kundër vendimeve përfundimtare ne fushën e inspektimit, paraqitet dhe shqyrtohet sipas parashikimit te Kodit te Procedurave Administrative.
2. “Organi Epror” sipas Kodit te Procedurës Administrative është një njësi apo organ kolegjal posaçërisht i krijuar brenda inspektoratit shtetëror, institucionit te varësisë pjese e te cilit është inspektorati shtetëror apo njësisë vendore përkatëse, dhe qe ka ne përbërje nëpunës te pavarur nga ata te përfshire ne vendimin e ankimuar.
3. Organin epror, për çdo inspektorat shtetëror përcaktohet nga Këshilli i Ministrave, ndërsa për inspektimet ne juridiksionin e qeverisjes vendore përcaktohet nga këshilli i njësisë se qeverisjes vendore përkatëse.

4. Përveçse kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji i posaçëm, paraqitja e ankimit administrativ pezullon ekzekutimin e vendimit përfundimtar të ankimuar por nuk cenon ekzekutimin e masave urgjente të marra sipas nenit 47 me sipër të këtij ligji.

Neni 56

Plotësimi i dispozitave të ligjit për kundravajtjet administrative

Përveç se kur parashikohet shprehimisht ndryshe, dispozitat e këtij kreu plotësohen me dispozitat e ligjit për kundravajtjet administrative

KREU VII

KUNDRAVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 57

Kundravajtjet administrative

1. Prishja e shenjave dalluese të ndalimit të veprimtarisë apo bllokimit të pajisjeve apo instalimeve si dhe çdo shenje të tjera të vendosura nga inspektorët, si dhe pengimi i inspektimit nëse nuk përbejnë veprën penale përbejnë kundravajtje administrative dhe dënohen me gjobe në masën. Të drejtën e konstatimit dhe shqyrtimit të kundravajtjes e ka çdo inspektor i inspektoratit që ka kompetencë në atë tip inspektimi.
2. Mosrespektimi i ndalimit të përcaktuar në pikën 2 të nenit 23 përbejnë kundravajtje administrative dhe dënohet me gjobe në vlerë nga 10000 në 100000 Lek. Të drejtën e konstatimit dhe shqyrtimit të kundravajtjes e ka inspektoratit ku personi ushtronte detyrën apo Inspektoratit Qendror.
3. Nëse një ligj i posaçëm përcakton një masë gjobe më të lartë për veprimet e parashikuara në pikën 1 e 2 me sipër, zbatohet masa gjobës e përcaktuar nga ligji i posaçëm

KREU VIII

DISPOZITA TRANSITORE DHE TË FUNDIT

Neni 58

Riorganizimi i trupave me funksione inspektimi

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të riorganizojë trupat dhe institucionet me funksione inspektimi në juridiksionin e institucioneve qendrore, sipas parimeve të përcaktuara nga ky ligj, brenda një periudhe 6 mujore nga hyrja në fuqi e tij.
2. Inspektorët dhe nëpunësit e tjerë që mbeten në detyrë pas organizimit sipas pikës 1 me sipër, do të konsiderohen nëpunës civil në periudhe prove 1 vjeçare që nga momenti i sistemit në strukturat e reja dhe i nënshtrohen certifikimit profesional përpara përfundimit të periudhës së provës.

Neni 59

Ligji i zbatueshëm për procedimet në proces

1. Procedimet administrative të inspektimit të nisura përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji do të vazhdojnë në përputhje me dispozitat e përcaktuara në këtë ligj.

Neni 60

Shfuqizime dhe dispozita tranzitore

1. Në gjithë legjislacionin në fuqi, lidhur me inspektimin në juridiksionin e institucioneve qendror, të gjithë dispozitat që kanë të bëjnë me krijimin, emërtesat, organizimin, funksionimin dhe varësinë institucionale të trupave inspektuese, pavarësisht nga tipi i tyre, shfuqizohen. Kompetenca për kryerjen e inspektimit në fushat e inspektimit të përcaktuara nga këto ligje do të konsiderohen të jenë dhëne “inspektoratit shtetëror kompetent”.
2. Pavarësisht nga pika 1 me sipër, deri në këtë riorganizim sipas pikës 1 të nenit 58 me sipër, trupat e inspektimit ekzistues vazhdojnë të funksionojnë sipas organizimit në momentin e hyrjes në fuqi të këtij ligji.
3. Çdo dispozite tjetër në kundërshtim me këtë ligj shfuqizohet.

Neni 61

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit në “Fletoren Zyrtare”.